

DEKRET
Nr. 449, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Skënderbeut”
zonjës Shpresa Gjongecaj (Vangjeli)**

“Në vlerësim të kontributeve themelore dhe meritave të qëndrueshme në dokumentimin dhe lëvrimin e disiplinës së numizmatikës, në suazën më të gjerë të hulumtimeve arkeologjike, në të cilën ajo është shquar si një nga specialistet e rralla në vendin tonë, duke u renditur, falë një pune të admirueshme dhe jashtë çdo protagonizmi, mes studiuesve më autoritativë në rrafsh ndërkombëtar, të trashëgimisë historike dhe arkeologjike të vendit tonë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj